

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 425 Prot.

Tiranë, më 30.032017

VENDIM Nr. 41, datë 24.03.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 5 të datës 24.03.2017, pasi shqyrtoi Konceptin e sondazheve arkeologjike për pikat me potencial arkeologjik të Fushatës së III, (Zona rreth Gradishtës së Peshtanit nga KP 134+500 deri në KP 133+500, Zona rreth Kalasë së Vojakës/Vojakut nga KP 129+500 deri në 129+085, Maja e Kodrës në fshatin Vojakë rreth KP 128+351, Maja e Malit të Therepelit rreth KP 118+730, Qafa/Pushimi i çobanit KP 95+500 dhe zona e KP 90+560) të *Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Konceptin e sondazheve arkeologjike për pikat me potencial arkeologjik të Fushatës së III, (Zona rreth Gradishtës së Peshtanit nga KP 134+500 deri në KP 133+500, Zona rreth Kalasë së Vojakës/Vojakut nga KP 129+500 deri në 129+085, Maja e Kodrës në fshatin Vojakë rreth KP 128+351, Maja e Malit të Therepelit rreth KP 118+730, Qafa/Pushimi i çobanit KP 95+500 dhe zona e KP 90+560) të *Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Për zonat me potencial arkeologjik të Fushatës së III, dhe pikërisht:
 - *Zona rreth Gradishtës së Peshtanit* nga KP 134+500 deri në KP 133+500, ku në sipërfaqen e disa fushave të punuara janë parë sasi të konsiderueshme qeramike dhe strukturash në vendet e njohura si Bregu i Hamamit dhe Gorica e Dukës (CH – 1070; CH – 1071; CH – 1072; CH – 1073; CH – 1074),
 - *Zona rreth Kalasë së Vojakës/Vojakut* nga KP 129+500 deri në 129+085(CH – 1079; CH 1077 CH – 630),
 - *Maja e Kodrës në fshatin Vojakë* rreth KP 128+351 (CH – 378) ku janë janë identifikuar mbetje të varreve e dëmtuara,
 - *Maja e Malit të Therepelit* rreth KP 118+730 ku janë identifikuar rrënojat e një ndërtese nga e cila kishin mbetur disa gjurma dhe linja muresh (CH-1087),



- **Qafa/Pushimi i çobanit KP 95+500 (CH-1108)** ku vëzhgimi arkeologjik ka gjetur shumë mbetje qeramike.
 - **KP 90+560 (CH-1106)** ku vëzhgimi arkeologjik ka gjetur shumë mbetje qeramike, të kryhen sondazheve arkeologjike, sipas konceptit të paraqitur.
3. Shoqëria "TAP AG" duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila do të kryejë sondazhet arkeologjike për zonat e sipërpërmendura të projektit "Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP), Fushata e III, KM 69 - KM 139,674, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri. Raporti i sondazheve dhe dokumentimi i gjetjeve të paraqiten në KKA e radhës.
 4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
 5. Investitori duhet të realizojë pas ndërtimit të gazsjellësit, rikthimin e terrenit në gjendjen e tyre të mëparëshme, përsa i përket sistemeve tarracuese dhe sinoreve (pikat e ndarjeve të kullotave), në zonat e Skraparit dhe të zonave malore të Korçës.
 6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
 7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO